





# Mësimi hibrid

Dokument orientues për shkollat profesionale



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:

  
swisscontact

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikqyrjen e Prof. Asoc. Dr. Erka Çaro, Zv. Menaxhere Projekti dhe Eriola Shingjergji, Menaxhere e Linjës për Digitalizimin në AFP.

### **Autore**

Prof. Asoc. Dr. Sonila Papathimiu

### **Kontributorë**

Dorian Memoçi

Genta Baholli

Jetmir Shtjefni

Juljan Kasapi

Rudina Gjoka

### **Rreth projektit “Aftësi për Punë” (S4J)**

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti “Aftësi për Punë” (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përfutuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

### **Pronësia intelektuale**

© Ky publikim është pronësi ekskluzive intelektuale e projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Publikimi mund të aksesohet, lexohet, shkarkohet apo printohet vetëm për përdorim personal. Ndalohet riprodhimi, shpërndarja, shitja, shfaqja, ndryshimi apo përshtatja e çdo materiali që përfshihet në publikim pa autorizim nga S4J.

**Shënim:** Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin

domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

## **PËRMBAJTJA**

<b>HYRJE .....</b>	<b>2</b>
<b>I ÇFARË ËSHTË MËSIMI HIBRID .....</b>	<b>2</b>
<b>II. AVANTAZHET E PËRDORIMIT TË MËSIMIT HIBRID NË MËSIMDHËNIE .....</b>	<b>3</b>
<b>III OBJEKTIVAT E PILOTIMIT TË MËSIMIT HIBRID NË SHKOLLAT E MESME PROFESIONALE .....</b>	<b>4</b>
<b>IV. NDIKIMI I PRAKTIKIMIT TË MËSIMIT HIBRID.....</b>	<b>4</b>
<b>V. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE PËR KRIJIMIN E NJË KLASE PËR MËSIMIN HIBRID .....</b>	<b>5</b>
<b>VI. MBËSHTETJA E MËSUESVE QË DO PËRDORIN MËSIMIN HIBRID .....</b>	<b>7</b>
<b>VII. STAFI I NEVOJSHËM PËR PILOTIMIN E MËSIMIT .....</b>	<b>8</b>
<b>VIII. PREVENTIV I KLASËS PËR MËSIMIN HIBRID.....</b>	<b>9</b>
<b>IX. AKTIVITETET KRYESORE TË PLANIT TË VEPRIMIT.....</b>	<b>10</b>

## Hyrje

Në përputhje me Udhërrëfyesin e Digjitalizimit “E-VET Shqipëria: Modernizimi i AFP-së përmes TIK” 2030 , Projekti “Aftësi për Punë” (S4J) mbështet transformimin e loAFP-ve përmes integritit të zgjidhjeve digjitale në proceset e planifikimit dhe lëvrimin të mësimdhënies, të nxënimit, monitorimit të ecurisë dhe vlerësimit të nxënësve, si dhe të arkivave elektronike.

Zhvillimi i digjitalizimit në AFP ka sjellë ndër të tjera edhe vënien në praktikë të elementeve të ndryshme të mësimin hibrid, veçanërisht në programet pas të mesme profesionale, duke krijuar një bazë për të zgjeruar më tej këtë qasje. Në këtë drejtim, u hartua ky propozim me konsultimin e disa shkollave profesionale në vend që ofrojnë programe të Nivelit të 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe që tashmë kanë krijuar një përvojë domethënëse me elemente të mësimin hibrid. Propozimi do të diskutohet gjerësisht në Shkollën Dimërore të S4J me specialistë të fushës dhe aktorë të tjerë të sektorit në dhjetor 2024. Pas rishikimit të tij, më pas do të pilotohet në loAFP-në e përzgjedhur në 2025.

## I ÇFARË ËSHTË MËSIMI HIBRID

Mësimi hibrid është një metodë mësimdhënieje që ndërthur mësimin tradicional në klasë me mësimin në distancë përmes platformave digjitale. Kjo qasje synon të ofrojë një përvojë të integruar për nxënësit, duke kombinuar përfitimet e prezencës fizike në shkollë me fleksibilitetin dhe aksesin e mundësuar nga teknologjia. Nxënësit mund të ndjekin leksionet në të njëjtën kohë, pavarësisht nëse janë fizikisht të pranishëm në klasë apo të lidhur nga distanca përmes platformave digjitale, duke krijuar kështu një mjedis të përbashkët të të mësuarit.

Elementet kryesore të mësimin hibrid lidhen me përdorimin e mjeteve të komunikimit si platformat e video konferencave dhe aplikacionet për menaxhimin e mësimin, për të siguruar ndërveprimin e vazhdueshëm midis mësuesit dhe nxënësve. Kjo kërkon një infrastrukturë të përshtatshme teknologjike, si pajisje audio-vizuale, lidhje të qëndrueshme interneti dhe mjedise të pajisura me teknologji bashkëkohore për të një përvojë mësimore të barabartë për të gjithë nxënësit, pavarësisht vendndodhjes së tyre.

Pas pandemisë, në vendin tonë, elementet e mësimin hibrid kanë vijuar të aplikohen kryesisht në arsimin e vazhduar të të rriturve, në programet post-sekondare. Projekti S4J do të mbështesë më tej këtë përvojë të vlefshme në linjë me modernizimin e sistemit të AFP-së të parashikuar edhe në udhërrëfyesin për Digjitalizimin 2030.

## II. AVANTAZHET E PËRDORIMIT TË MËSIMIT HIBRID NË MËSIMDHËNIE

Zhvillimi i mësimi në mjediset shkollore, jo gjithmonë është i mundur për të gjithë. Kjo ndikon, që një numër i madh i të interesuarve për të vazhduar studimet apo për kualifikime të veçanta, nuk mund të regjistrohen apo të frekuentojnë kurset dhe trajnimet e dëshiruara, sepse jetojnë larg shkollës, janë në punë dhe nuk u përshtaten orareve të shkollës, kanë probleme shëndetësore etj. Nga ana tjetër, nxitja dhe përhapja e konceptit të të mësuarit gjatë gjithë jetës kërkon edhe rritjen e kapaciteve njerëzore e teknologjike për ta realizuar atë në shkallë të gjerë dhe të jetë gjithëpërfshirës.

Pandemia Covid-19 nxit, përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie, si dhe përhapjes së mësimi online sinkron nëpërmjet platformave apo aplikacioneve të ndryshme duke sjellë ndryshime rrënjësore në aftësimin didaktiko-digjital të mësuesve dhe nxënësve. Pas pandemisë, një numër më i madh shkollash dhe mësuesish kanë përshtatur programet e tyre dhe kanë futur në përdorim mësimin online sinkron ose asinkron, mësimin hibrid, klasat e përmbysura etj.

Mësimi hibrid, i cili nënkupton realizimin e mësimi njëkohësisht për nxënësit që janë fizikisht në klasë dhe ata që janë të lidhur online është shumë i përshtatshëm për krijimin e mundësive për më shumë gjithëpërfshirje. Ky lloj mësimi është shumë i përshtatshëm që të fillojë të përdoret gjerësisht në kurset e kualifikimit që i përkasin Nivelit 5 të kualifikimit, sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit (KSHK). Ky nivel përfshin programet e studimit deri në dy vjet pas arsimit të mesëm/Kualifikime për menaxherë të rinj dhe për teknikë të lartë deri në dy vjet pas arsimit të mesëm (Diplomë Profesionale) dhe organizohet nëpërmjet kurseve për menaxherë, specialistë dhe teknikë të lartë sipas niveleve të "Arsimit Profesional" duke u pajisur në fund me "Certifikatë Profesionale" e njohur nga sistemi shqiptar i kualifikimit.

Mësimi hibrid që do të ofrohet për Nivelin 5 të KSHK-së synon të krijojë mundësi për individë të interesuar në frekuentimin e programit, që për arsye të ndryshme nuk mund të ndjekin mësimin çdo ditë në shkollë.

Disa nga avantazhet e përdorimit të mësimi hibrid janë:

- Fleksibilitet në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
- Përhapje më e gjerë e mundësive për të mësuar duke arritur edhe zona të thella.
- Është i mundur për njerëz të grupmoshave të ndryshme si dhe me aftësi ndryshe.
- Ul ndjeshëm mungesat e gjata të nxënësve në mësim, sidomos të atyre që kanë sëmundje kronike ose me regjim shtrati në shtëpi ose spital.
- Familjarizon përdoruesit me teknologjinë moderne.

### III OBJEKTIVAT E PILOTIMIT TË MËSIMIT HIBRID NË SHKOLLAT E MESME PROFESIONALE

Objektivi kryesor është krijimi i kushteve paraprake dhe aplikimi i mësimit hibrid në programet e Nivelit 5 të kualifikimeve sipas KSHK që ofrohen në IoAFP-të, për të rritur efikasitetin dhe gjithëpërfshirjen e të gjithë të interesuarve në aftësimin dhe rritjen e tyre profesionale.

#### **Objektivat specifikë:**

1. Lehtësimi dhe rritja e frekuentimit të kurseve dhe trajnimeve për mësimin e vazhdueshëm;
2. Përmirësimi i aftësive dhe njohurive praktike të pjesëmarrësve;
3. Rritja e bashkëpunimit dhe rrjetëzimit midis mësuesve, nxënësve dhe bizneseve përkatëse;
4. Shtimi i përdorimit të metodave bashkëkohore në mësimdhënie;
5. Diversifikimi i ofertës në Arsimin Profesional etj.

### IV. NDIKIMI I PRAKTIKIMIT TË MËSIMIT HIBRID NË SHKOLLAT E MESME PROFESIONALE TË SHQIPËRISË

Praktikimi i mësimit hibrid në Shkollat e Mesme Profesionale për kurset dhe trajnimet e Nivelit 5 të kualifikimeve pritet të ndikojë në disa aspekte dhe të përmirësojë situatën në lidhje:

- **Përfshirje më të lartë** në kurset dhe trajnimet e Nivelit 5 të ofruara në Shkollat e Mesme Profesionale të Shqipërisë. Në mësimin hibrid mund të përfshihen më shumë nxënës pavarësisht moshës së tyre, gjinisë, kushteve ekonomike, vendndodhjes apo karakteristikave të tjera që i pengojnë nga ndjekja e rregullt fizikisht e shkollës.
- **Rritje e aftësive digjitale të mësuesve dhe nxënësve**, nëpërmjet praktikimit të mësimit hibrid, i cili kërkon ndërveprim të lartë me teknologjinë dhe përdorim më të gjerë të platformave dhe aplikacioneve digjitale. Mësuesit trajnohen rregullisht për përdorimin e pedagogjisë digjitale, për shtimin e përdorimit të metodave bashkëkohore në mësimdhënie, për të rritur efikasitetin dhe suksesin e metodës së mësimdhënies hibride;
- **Rritje e bashkëpunimit dhe shanseve për punësim**. Duke ndjekur kurset dhe trajnimet me metodën hibride, nxënësit mësohen të bashkëpunojnë me nxënësit e tjerë dhe mësuesin fizikisht dhe virtualisht njëkohësisht dhe kjo rrit aftësitë e tyre në komunikim dhe të përshtatshmërisë sipas kushteve. Këto janë aftësi që i ndihmojnë në profesionin e tyre dhe në menaxhimin e duhur të situatave.

## V. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE PËR KRIJIMIN E NJË KLASE PËR MËSIMIN HIBRID

Për të realizuar mësimin hibrid me sukses duhet të krijojmë një klasë të pajisur me teknologjinë e përshtatshme për këtë lloj mësimi.

### **1. Desktop dhe/ose Laptop**

Në një klasë të mësimin hibrid, është shpesh më i preferuar përdorimi i laptopëve për shkak të portabilitetit dhe pajisjeve të integruara si kamera dhe mikrofoni. Megjithatë, mund të përdoren edhe desktopët me kamera dhe sistem audio të jashtëm, me kusht që të kenë standarde të larta për kujtesën (RAM), kartën grafike dhe procesorin, për të lehtësuar ndërveprimin me platformat dhe aplikacionet digjitale.

### **2. Lidhje e shpejtë dhe e qëndrueshme interneti**

Në klasën që do të zhvillohet mësimi hibrid është një kusht i rëndësishëm interneti në të dy format, me lidhje me tela dhe pa tela (Wi-Fi). Të gjitha platformat e video-konferencave që do të përdoren për lidhjen online funksionojnë vetëm nëpërmjet internetit. Për mësimin hibrid është e domosdoshme një lidhje interneti e qëndrueshme dhe me shpejtësi të lartë, në mënyrë që ndërveprimi me nxënësit online të jetë sa më i qartë dhe pa ndërprerje. Po kështu, brenda mundësive, sugjerohet një sinjal i dedikuar Wi-Fi vetëm për atë klasë.

### **3. Sistemi i kamerave**

Mësimi hibrid është një metodë që vendos në qendër nxënësin dhe kjo kërkon që mësuesi dhe nxënësit të ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe ta shohin njëri-tjetrin në kohë reale, pavarësisht nëse janë fizikisht apo virtualisht në klasë. Edhe pse laptopët dhe desktopët mund të realizojnë lidhjen audiovisive, për këtë lloj mësimi rekomandohet përdorimi i kamerave me kënd të gjerë. Ky tip kamere mund të mbulojë të gjithë klasën dhe të fokusohet automatikisht tek personi që flet, për t'i bërë diskutimet më të kuptueshme për të gjithë nxënësit, pavarësisht nëse janë të pranishëm online apo fizikisht. Këtu mund të përmendim Poly studio USB web bar, me kamera dhe audio të integruara me një rreze 120°, e cila vendoset në një nga muret e klasës. Një tjetër shembull është Meeting owl Pro, kamera që filmon 360° dhe shumë e përshtatshme për një klasë për mësimin hibrid, me sistemin audio të integruar. Mund të shoqërohet me Owl whiteboard për një pamje më të qartë të tabelës ku shkruan mësuesi ose nxënësit.

### **4. Mikrofonë dhe pajisje për sistemin e zërit**

Sistemi i zërit është gjithashtu shumë i rëndësishëm për zhvillimin cilësor të mësimin hibrid. Shpeshherë mendohet se mikrofonët e integruar apo të jashtëm të laptopit apo desktopit janë të përshtatshëm, por në fakt ata nuk janë në gjendje të kapin të gjitha diskutimet që zhvillohen në klasë, mësuesi do të jetë i detyruar të rrijë pranë mikrofonit dhe nuk ndërvepron shumë me ata që janë fizikisht.

Për një klasë hibride, rekomandohet përdorimi i mikrofonëve me sistem për eliminimin e zhurmave dhe me mbulim të gjerë, në mënyrë që mësuesi ose nxënësit të dëgjojnë qartë nga çdo pjesë e klasës pa ndërprerje. Mikrofonë të tillë janë p.sh. Chatbox; Rode Wireless Go etj. Tjetër mundësi është edhe Audio Nureva® , e cila përdor teknologjinë e patentuar Microphone Mist™ që mbush një klasë me mijëra mikrofona virtualë, kështu që të gjithë mund të dëgjojnë, nga kudo.

## 5. Platforma digjitale të përshtatshme për bashkëpunim

Për të pasur ndërveprim më të lartë gjatë mësimit hibrid, rekomandohet përzgjedhja e një platforme për menaxhimin e mësimit, e cila të jetë e aksesueshme për të gjithë. Një alternativë e përshtatshme për këtë është Mesovet. al platformë e bazuar në moodle, e adaptuar në shqip për AFP-në. Kjo platformë është e aksesueshme dhe lehtëson komunikimin e dyanshëm mes mësuesit dhe nxënësve, duke përbushur nevojat për krijimin e materialeve digjitale, vlerësimin dhe zhvillimin e elementeve të tjera të pedagogjisë digjitale.

## 6. Teknologjia për prezantimet në klasë

Për mësimin hibrid, ekranet dhe pajisje të tjera prezantuese kanë më shumë rëndësi për nxënësit që janë fizikisht në klasë, sepse për ata online, mjafton që materiali të shfaqet në platformën e zgjedhur në desktopin apo laptopin e mësuesit. Për një klasë të mësimit hibrid mund të përzgjidhet midis disa alternativave për prezantimet.

- **Tabelë e bardhë ndërvepruese**, e cila imiton funksionalitete të tabelës së klasës dhe ku mund të bëhen shënime të ndryshme, por që ofrojnë edhe një ekran interaktiv. Një tabelë e tillë do të shtonte ndërveprimin dhe përfshirjen e nxënësve. Funksionalitetet e saj do të ishin më të mira, nëse edhe nxënësit që janë lidhur online kanë një laptop me prekje dhe të përfshihen direkt për të shkruar dhe ndarë mendimet e tyre në tabelën e bardhë ndërvepruese.
- **Projektorët**, të cilët janë përhapur shumë dhe luajnë një rol të rëndësishëm në prezantimin e mësimit dhe projekte e prezantime të nxënësve. Projektorët janë një zgjidhje efikase dhe ekonomike. Duke qenë se janë futur më shpejt në mësime, projektorët janë lehtësisht të përdorshëm nga një numër i madh mësuesish.
- **Ekranet prezantuese të lidhur me internetin ose smartboard**. Ekranet prezantuese, si ato që përdoren për reklama të ndryshme, nuk kanë mundësinë e komandimit me prekje direkt në ekran dhe përdoren më shumë për të shfaqur prezantimet në power point, video apo ilustrime të ndryshme. Meqë nuk ka opsionin e komandimit me prekje, ai mund të vendoset më lart dhe të jetë më i dukshëm nga të gjithë nxënësit në një klasë. Ndërsa, nëse vendosim smartboard, atëherë kemi edhe mundësinë e komandimit dhe ndërveprimit me prekje në ekran dhe në këtë rast do të vendoset deri në lartësinë e duhur për të realizuar të gjitha komandat nga mësuesit dhe nxënësit.



### Tabelë përmbledhëse 1

Teknologjia e nevojshme për të krijuar një klasë për mësimin hibrid

Nr.	Lloji i pajisjes ose software	Shembuj/Parametrat
1.	Desktop dhe/ose Laptop	RAM mbi 4GB, preferohet 8 ose 16GB , kartë grafike mbi 4 GB.
2.	Lidhje e shpejtë dhe e qëndrueshme interneti	Shpejtësi shkarkimi të paktën 100 Mbps dhe shpejtësi ngarkimi të paktën 10 Mbps. Lidhje me fibra optike.
3.	Sistemi i kamerave	Kamera me rezolucion të lartë. Tipet si: Meeting owl 3, USB ëeb bar
4.	Mikrofonë dhe pajisje për sistemin e zërit (të jashtme) opsionale	Mikrofonë të madhësive të ndryshme, mundësisht që eliminojnë zhurmat
5.	Platforma digjitale të përshtatshme për bashkëpunim	MësoVET
6.	<b>Teknologjia për prezantimet në klasë</b>	
	a. Tabelë e bardhë ndërvepruese	ViewSonic,
	b. Projektor	Epson; Sony etj. me porta të ndryshme hyrëse dhe dalës
	c. Ekranë prezantuese të lidhur me internetin ose smartboard.	Ekranë të firmave të njohura si: IQBoard; ViewSonic; BenQ etj.

## VI. MBËSHTETJA E MËSUESVE QË DO PËRDORIN MËSIMIN HIBRID

Mësimi hibrid do të pilotohet me ata mësues që kanë aftësi të mira digjitale dhe që kanë eksperiencë më të gjatë në mësimdhënie online dhe përdorimin e platformës digjitale Mësovet.

Mësimi hibrid kërkon që mësuesit të planifikojnë orën e mësimit për gjithëpërfshirje si të nxënësve me prezencë fizike ashtu edhe atyre online, duke siguruar që të dy grupet të marrin një përvojë mësimore të barabartë dhe tërheqëse. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje të hartojnë, menaxhojnë dhe vlerësojnë qasjet mësimore që përshtatin stilet dhe nevojat e ndryshme të nxënësve të tyre, pavarësisht nga vendndodhja e tyre.

Investimi për të mbështetur mësuesit që do përdorin mësimin hibrid duhet të synojë:

- **Zhvillimin profesional të mësuesve:** Duhet të parashikohen seminare, trajnime të shkurtra, webinarë për zhvillimin e vazhdueshëm të mësuesve për t'i ndihmuar të zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të dhënë mësim me metodën hibride. Tematika të seminareve dhe trajnimeve mund të jenë: Njohja dhe përdorimi i infrastrukturë fizike digjitale, aftësimi në përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies (mësimi i bazuar në probleme, në raste

studimi, klasa e përmbysur, mësimi i bazuar në projekte), përdorimi i aplikacioneve dhe platformave në mësimdhënie, aftësimi në programe të veçanta për përdorimin e pedagogjisë digjitale, menaxhimi i klasës në një mjedis fizik dhe virtual njëkohësisht etj.

- **Aksesin në teknologji:** Mësuesit që do të përfshihen në mësimin hibrid do të duhet të kenë në dispozicion teknologjinë e duhur digjitale dhe të trajnohen për të eksperimentuar mësimdhënien hibride me anë të tyre. Disa nga mjetet që duhet t'i kenë në dispozicion përfshijnë pajisjet hardëare të ndryshme (kompjuter, laptop). Laptop-i personal në disa raste konsiderohet më i përshtatshëm, sepse i jep mundësi mësuesit të shtojë dhe përmirësojë materialet e tij digjitale në çdo kohë. Gjithashtu, duhet të sigurohet akses, abonime dhe trajnim për të përdorur platforma dhe aplikacione të domosdoshme për një mësim hibrid të suksesshëm.
- **Krijimin e kushteve për bashkëpunim dhe rrjetëzim të mësuesve që do përdorin mësimin hibrid:** Nxisni dhe krijoni kushtet që mësuesit të rrisin bashkëpunimin midis tyre dhe krijimit të një rrjeti për të ndarë eksperiencat dhe vështirësitë, që të përmirësojnë mësimdhënien hibride. Rrjetëzimi mund të inkurajohet edhe në bazë të drejtimeve kryesore profesionale dhe bashkëpunimi mund të nxitet për të krijuar materiale të përbashkëta mësimore. Mësuesit duhet të inkurajohen që të kenë takime të rregullta fizikisht, online ose hibride me anëtarët e rrjetit dhe të diskutojnë për përmirësimin e mësimdhënies.
- **Krijimin e mundësisë që mësuesit të shfaqin shqetësimet dhe vlerësimet e tyre në lidhje me praktikimin e mësimin hibrid:** Mësuesit që do të praktikojnë mësimin hibrid duhet të kenë mbështetje të vazhdueshme dhe tu merren parasysh shqetësimet e shfaqura. Gjithashtu, duhet të planifikohet vlerësim i ecures së mësimin hibrid nëpërmjet pyetësorëve drejtuar nxënësve, kolegëve të tjerë, vlerësime nga institucioni dhe të adresohen të gjitha problematikat e shfaqura për të përmirësuar mësimin hibrid.

## VII. STAFI I NEVOJSHËM PËR PILOTIMIN E MËSIMIT

Për mbarëvajtjen e zbatimit të mësimin hibrid në një shkollë profesionale, është e nevojshme të krijohet një grup përgjegjës me këto funksione:

- Koordinator i përgjithshëm i projektit të pilotimit të mësimin hibrid;  
*Detyra kryesore:* Koordinon gjithë veprimtaritë për pilotimin e mësimin hibrid; Lehtëson komunikimin midis palëve të përfshira; Sigurohet për zbatimin në kohë të planit, përdorimin e buxhetit sipas zërave dhe vlerësimin e ecures së mësimin hibrid.
- Ekspert ose Mbështetës IT për mësuesit dhe nxënësit;  
*Detyra kryesore:* Krijon kushtet teknike për zbatimin e mësimin hibrid; Ofron ndihmë teknike për mësuesit dhe nxënësit që hasin probleme gjatë mësimin hibrid; Ndihton në përzgjedhjen e mjeteve teknologjike dhe platformave apo aplikacioneve që do të përdoren etj.
- Mësues me aftësi mesatare digjitale dhe praktikues të metodave bashkëkohore të mësimdhënies;

*Detyra kryesore:* Siguron zbatimin me efikasitet të mësimit hibrid nëpërmjet përshtatjes së kurrikulës për këtë lloj mësimi; Përfshin metoda bashkëkohore të mësimit dhe përdorim të gjerë të platformave dhe aplikacioneve digjitale në mësimit; Kujdeset për zhvillimin profesional të vazhdueshëm duke marrë pjesë në trajnime dhe seminare në lidhje me zbatimin e mësimit hibrid.

- Trajner për aftësimin e mësuesve në aplikimin e mësimit hibrid;

*Detyrat kryesore:* Përgatit dhe ofron trajnime, seminare apo ëëbinare për mësuesit që do të përdorin metodën e mësimit hibrid; Ofron trajnime në lidhje me platformat apo aplikacionet më të përshtatshme për mësimit hibrid; Ndhmon mësuesit me nevoja specifike kur është e nevojshme.

- Staf tjetër administrativ;

*Detyrat kryesore:* Siguron mbarëvajtje të mësimit hibrid, rregullon oraret dhe merret me punë të tjera logjistike.

## VIII. PREVENTIV I KLASËS PËR MËSIMIN HIBRID

Nr.	Zëri në buxhet	Çmimi i përafërt (në euro) sipas nivelit të parametrave dhe cilësisë			
		Bazike	Mesatare	të Avancuar	
1.	<b>Pajisje teknologjike dhe të tjera:</b>				
	<b>a. Pajisje audio vizuale:</b>	1. Kamera	350	600	1200
		2. Mikrofon dhe Spikër	150	300	550
		3. Projektor ose Ekran i Madh	600	900	1200
		4. Tabelë e bardhë ndërvepruese	900	1800	2700
	<b>b. Kompjuter dhe/ose laptop:</b> Për mësuesit dhe nxënësit (çmimi për njësi)	450	700	1300	
	<b>c. Pajisje për rrjetin e internetit:</b> Router; Switch: kablllo për lidhje të qëndrueshme interneti	300	700	1100	
2.	Abonime ose blerje Platforma ose aplikacione për krijimin e materialeve digjitale si Canva; Mentimeter; Kahoot etj.	400	700	1200	
5.	Shpenzime për Trajnim dhe mbështetje të tjera	500	1200	2000	
6.	Shpenzime të tjera	400	900	1500	
7.	<b>Totali sipas zërave dhe cilësisë</b>	<b>4,050</b>	<b>7,800</b>	<b>12,750</b>	

*Shënim:* Çmimi është i përafërt për të gjitha kategoritë dhe totali është në rastin kur do të blihet vetëm një Kompjuter ose Laptop për klasë.

#### IX. Aktivitetet Kryesore të Planit të Veprimit

	<b>Aktiviteti</b>	<b>Kur</b>	<b>Kush</b>
1	Rishikimi i propozimit	Tetor 2024	Ekspertë/Mentorë të Transferimit
2	Finalizimi i propozimit	Tetor 2024	S4J
3	Faqosja & finalizimi i produktit	Nëntor 2024	S4J
4	Diskutimi i Propozimit	Shkolla Dimërore	Pjesëmarrësit
5	Rishikimi i Propozimit sipas komenteve	Janar 2025	S4J
6	Identifikimi i IoAFP-së pilotuese	Muaji I i pilotimit	S4J
7	Krijimi i Grupit të Pilotimit dhe përgatitja e planit të detajuar të pilotimit	Muaji I i pilotimit	Shkolla pilotuese, S4J
<b>Pilotimi</b>			
8	Detajimi i Planit të Punës	Muaji I i pilotimit	S4J, IoAFP pilotuese në bashkëpunim me AKAFPK
9	Trajnimi i mësuesve të përzgjedhur	Muaji II i pilotimit	Ekspertë të S4J
10	Mentorim/Coaching i mësuesve	Muaji III-IV i pilotimit	Ekspertë të S4J
11	Monitorimi i Zbatimit	Vazhdimisht	Ekspertë të S4J
12	Vlerësimi i pilotimit	Muaji fundit i pilotimit	Ekspertë të S4J
13	Raporti përfundimtar & Rekomandimet	Korrik 2025	Ekspertë të S4J
14	Seminar Validues për Përvojën dhe Perspektiva për përhapjen e Mësimit Hibrid	Korrik 2025	S4J, aktorët përkatës.
15	Hartimi i Propozimit për përhapjen e Mësimit Hibrid	Tetor 2025	S4J
17	Përgatitja e Planit të Veprimeve	Dhjetor 2025	S4J, me agjencitë përkatëse

Ky propozim për pilotimin e mësimit hibrid paraqitet në vazhden e “menusë” së zgjidhjeve të larmishme të mbështetura nga Projekti S4J për një edukim më të aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës. I ndërtuar mbi përvojat e deritanishme të disa shkollave profesionale që ofrojnë programe pas të mesme, dokumenti synon të shërbejë si bazë për një diskutim të gjerë dhe për veprime konkrete në të ardhmen.